



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

## **KPA Nr. 002 – Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet – 2021**

Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

Data e publikimit: 10 shkurt, 2021  
Sesionet informuese: 16 shkurt, 2021 (në gjuhën shqipe)  
18 shkurt, 2021 (në gjuhën serbe)  
Data e mbylljes: **11 mars, 2021**  
Ora e mbylljes: 17:00

**Tema:** Kërkesë për Aplikime (KPA) Nr. 002 – Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet – 2021

**Titulli:** Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

**Referenca:** E lëshuar nga programi i Aktivitetit për Bashkëpunim në Komunitet, urdhërblerja e USAID me numër 72016720P00008



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

## Përmbajtja

<b>HISTORIKU</b>	3
<b>QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET</b>	3
<b>KRITERET E PËRZGJEDHJES</b>	4
Organizatave e pranueshme	4
Organizatave e papranueshme	5
Aktivitetet e pranueshme	6
Aktivitetet e papranueshme dhe shpenzimet e palejueshme	6
<b>PAKOJA E APLIKIMIT PËR GRANTE</b>	7
<b>VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PËRFITUESVE TË GRANTEVE</b>	8
Kriteret e vlerësimit	8
<b>PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESAVE</b>	10
<b>ANEKSI A. FUSHAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NË FORMULARIN ONLINE PËR APLIKIM</b>	11
<b>ANEKSI B. FORMULARI PËR BUXHET</b>	13
<b>ANEKSI C. UDHËZIMET PËR T’U PAJISUR ME NUMRIN DUNS</b>	13



## HISTORIKU

Niveli i pjesëmarrjes publike në Kosovë vazhdon të jetë i ulët, veçanërisht i grave dhe të rinjve, ndërsa shumica e qytetarëve ende nuk e kanë ndjenjën e përgjegjësisë qytetare për të marrë pjesë në çështje publike që prekin vetë ata dhe komunitetet e tyre. Për më tepër, bashkëpunimi në mes të komuniteteve të ndryshme etnike, sidomos duke u nisur nga fakti që problemet e tyre i tejkalojnë ndarjet etnike dhe i prekin të gjithë njëlloj, vazhdon të mbetet një sfidë e madhe. Nga ana tjetër, institucionet publike të Kosovës tregojnë nivel të ulët të përgjegjësisë, duke rezultuar kështu në kënaqshmëri të ulët të qytetarëve. Komunitat si adresë e parë për ofrimin e shërbimeve publike shpesh nuk janë aq efikase në ofrimin e tyre, veçanërisht të atyre shërbimeve që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës së qytetarëve. Në shumicën e rasteve, komunitat nuk bëjnë përpjekje shtesë përtej përmbushjes së obligimeve ligjore për dhënien e mundësive dhe motivimin e qytetarëve për të marrë pjesë në hartim të politikave publike që ndikojnë në cilësinë e jetës së tyre. Për më tepër, qeveritë lokale përgjithësisht perceptohen si joefikase dhe të ngadalta në adresimin e nevojave të qytetarëve të tyre.

Duke mbështetur iniciativa që bazohen në nevoja të identifikuar dhe zgjidhje lokale, e që trajtojnë në mënyrë proaktive sfidat që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirje në vendimmarrje, CCA synon të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes së komunave të Kosovës dhe ndërtimin e aktivizmit në komunitet. Konkretisht, organizata dhe iniciativa vendore me qasje inovative do të mbështeten financiarisht dhe teknikisht për ta rritur nivelin e përfshirjes së qytetarëve me proceset e politik-bërjes së komunave të tyre, me fokus të veçantë të gratë, të rinjtë dhe komunitetet joshumicë; ndërtimin e bashkëpunimit në komunitet rreth çështjeve të përbashkëta; dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe qytetarëve, duke rezultuar kështu në rritjen e kënaqshmërisë qytetare me performancën e komunave të tyre.

## QËLLIMET, OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Përmes kësaj thirrjeje, USAID kërkon aplikime për aktivitete që u përgjigjen dy objektivave strategjikë dhe kontribuojnë në katër rezultatet e Aktivitetit të Bashkëpunimit në Komunitet (CCA) siç listohen më poshtë.

CCA ka dy **objektiva strategjikë**: (1) *Të kontribuojë në rritjen e përfshirjes së qytetarëve në identifikimin dhe adresimin e sfidave të komunitetit lokal të grupeve të nënpërfaqësuar veçanërisht: gratë, të rinjtë dhe komunitetet joshumicë; dhe* (2) *Të kontribuojë në përmirësimin e bashkëpunimit multi-etnik për çështje që lidhen me komunitetin dhe bashkëpunimin ndërmjet qytetarëve të grupeve të ndryshme etnike dhe qeverive të tyre lokale.*

### Rezultatet e CCA:

**Rezultati 1:** Përfshirje më e madhe qytetare në identifikimin dhe zgjidhjen e sfidave të komunitetit lokal (me fokus të veçantë të gratë, të rinjtë dhe qytetarë tjerë të papërfaqësuar);

**Rezultati 2:** Përmirësim i bashkëpunimit multi-etnik rreth çështjeve që kanë të bëjnë me komunitetet në Kosovë;

**Rezultati 3:** Bashkëpunim më i mirë ndërmjet qytetarëve dhe qeverisjes komunale;

**Rezultati 4:** Rritje e kënaqshmërisë qytetare me performancën e komunave të tyre.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

## GRANTET PËRMES KONTRATËS

Ky është rundi i dytë i aplikimeve për grante të vogla në kuadër të CCA. Në këtë rund, CCA do të jap deri në dhjetë (10) grante me vlerë deri në \$11,000 për grant, të negociuara sipas temës dhe aktiviteteve që propozohen nga përfituesi i grantit.

**USAID rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë nga aplikacionet e paraqitura.**

## KOHËZGJATJA E PROJEKTIT

Zbatimi i projektit mund të zgjasë në një maksimum prej 8 muajsh.

## VENDI I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Grantet mund të implementohen në gjithë Kosovën, me ç'rast inkurajohen iniciativat ndërkomunale.

## SESIONET INFORMUESE

Në përputhje me situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, sesionet informuese do të mbahen në mënyrë virtuale përmes platformës Zoom. Një sesion do të mbahen në gjuhën shqipe dhe një sesion në gjuhën serbe, sipas orarit si në vijim:

Për aplikantët potencialë që flasin gjuhën shqipe: **16 shkurt, 2021** (10:30 @Zoom platform: <https://zoom.us/j/96968574455>)

Për aplikantët potencialë që flasin gjuhën serbe: **18 shkurt, 2021** (10:30 @Zoom platform: <https://zoom.us/j/96345265379>)

Sesionet informuese do të ofrojnë të dhëna më të hollësishme mbi qëllimin e aktivitetit dhe procedurat për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikacioneve. Subjektet e interesuara do të kenë mundësi të parashtrajnë pyetje të tjera shtesë edhe përmes emailit: [grants@dplus.org](mailto:grants@dplus.org).

## KRITERET E PËRZGJEDHJES

### Organizatave e pranueshme

Këshillat rinore lokale për këshillëdhënie, OJQ-të lokale, grupe që kanë për bazë komunitetet dhe çështje të ngjashme, subjekte të sektorit privat, organizata të shoqërisë civile dhe mediat.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

Përfituesit duhet të jenë subjekte të regjistruara ligjërish. Institucionet komunale dhe institucionet e tjera publike (p.sh. shkollat publike, spitalet, universitetet) nuk mund të aplikojnë për këto grante në mënyrë të drejtpërdrejt, por entitetet që kanë mundësi të aplikojnë inkurajohen fuqishëm t'i përfshijnë të njëjtat si partnere. Për të qenë të përshtatshme për t'u bërë pjesë e këtyre thirrjeve, entitetet lokale apo organizatat tjera lokale fitimprurëse apo jofitimprurëse duhet:

- Të jenë të organizuara sipas ligjeve të Kosovës;
- Të ushtrojnë veprimtaritë kryesore në Kosovë;
- Të jenë në pronësi të individëve të cilët janë qytetarë ose banorë të përhershëm me qëndrim të ligjshëm në Kosovë ose të menaxhohen nga një organ udhëheqës, ku shumica e tyre duhet të jenë qytetarë apo banorë të përhershëm me qëndrim po ashtu të ligjshëm në Kosovë;
- Të mos kontrollohen nga një entitet i huaj ose nga individë të cilët nuk janë shtetasë ose banorë të përhershëm të Kosovës ("kontrollë" në këtë kontekst nënkuptohet pronësia mbi pjesën më të madhe të fitimit, siç është përcaktuar më sipër apo ushtrimi i pushtetit në mënyrë direkte apo indirekte në zgjedhjen, emërimin dhe përcaktimin e mandatit të menaxherëve të organizatës ose organit drejtues të organizatës qoftë përmes pronësisë, kontratës apo përmes ligjit).
- Të ketë buxhet vjetor në vitin paraprak financiar që nuk e tejkalon shumën prej 50,000 euro.

**Përfituesit e granteve duhet ta prezantojnë te CCA numrin e tyre DUNS dhe numrin Bradstreet bashkë me aplikacionin e tyre, po ashtu duhet ta konfirmojnë regjistrimin përmes Sistemit të Menaxhimit të Çmimeve (SAM).** Për udhëzime se si të pajiseni me numrin DUNS, shih aneksin C: Udhëzime për t'u pajisur me numrin DUNS. Sipas kërkesës dhe nevojës, CCA do të ofrojë ndihmë shtesë lidhur me marrjen e këtij numri.

## Organizatat e papranueshme

Subjektet si në vijim nuk mund të marrin grante nga CCA:

- Entitetet që kanë keqpërdorur fondet e USAID në të kaluarën (përveç nëse aprovet nga Zyrtari Kontraktues).
- Partitë politike, grupimet, institucionet, degët apo filialet e tyre.
- Organizatat që avokojnë, promovojnë ose përkrahin politikat antidemokratike ose aktivitetet ilegale.
- Organizatat që kanë për bazë diskriminimin dhe që janë të krijuara për qëllime religjioze.
- Cilido entitet apo individ brenda entitetit që është i përfshirë në ndonjë gjë të ndaluar e që ky informacion mund të sigurohet nga USAID nga burime të tjera.
- Cilido entitet që i figuron emri në Sistemin për Menaxhimin e Çmimeve (SAM) – [www.sam.gov](http://www.sam.gov).
- Organizatat që refuzojnë t'i nënshkruajë çertifikimet e kërkuara.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

## Aktivitetet e pranueshme

Aktivitetet që financohen nga CCA përmes granteve duhet të jenë në përputhje me kriteret e përgjithshme si në vijim:

- Të promovojnë objektivat e përgjithshme të CCA dhe të kontribuojnë në katër rezultatet e lartë përmendura.
- Mund të trajtojnë një numër temash, përfshirë këtu pjesëmarrjen demokratike, artin dhe kulturën, sportin, zbutjen e varfërisë, ruajtjen e kulturës, çështjet mjedisore, arsimimin, të kuptuarit e mediave dhe tema të tjera që kontribuojnë në objektivat strategjike të CCA dhe në katër rezultatet e pritshme. Të gjitha iniciativat që do të mbështeten përmes këtyre granteve duhet të kenë rezultate të matshme dhe të jenë në përputhje me katër rezultatet e CCA.
- Zhvillimi i aktiviteteve të grantit duhet të bëhet në Kosovë dhe me përfitues Kosovarë.
- Aktivitetet mund të nisin vetëm pas nënshkrimit të kontratës ndërmjet fituesit të grantit dhe D+. Shpenzimet e bëra përpara lidhjes së kësaj kontrate nuk do të rimbursohen.

Aktivitetet e propozuara duhet të jenë në përputhje me masat e vendosura nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për parandalimin e shpërndarjes së pandemisë COVID-19. Më poshtë mund t'i gjeni disa shembuj ilustrativ të llojeve të aktiviteteve që mund të propozohen (Shënim: kjo listë nuk është gjithëpërfshirëse, andaj iniciativat dhe idetë kreative janë të mirëseardhura):

- Takime/trajnime virtuale, uebinare, etj.;
- Fushata online për rritjen e vetëdijësisë;
- Krijimi dhe shpërndarja online e pamjeve vizuale;
- Platforma për angazhim qytetar;
- Hulimtim i tipit “desk research” dhe monitorim.

## Aktivitetet e papranueshme dhe shpenzimet e palejueshme

Grantet nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të cekura si në vijim:

- Mbështetje të programeve politike apo programeve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me mbështetjen e partive politike apo bizneseve individuale.
- Aktivitete që kanë të bëjnë me ndërtim (përfshirë këtu edhe renovime të vogla), aktivitete bujqësore (përfshirë edhe kopshtet në komunitet) ose cilido aktivitet që e dëmton ambientin.
- Programe që përfshijnë blerje të pajisjeve për përdorim të gjerë.
- Ceremoni private, festa, kremtime apo shpenzime për “përfaqësim”.
- Blerja e të mirave dhe shërbimeve të kufizuara apo ndaluara nën rregullat mbizotëruese të USAID të burimit/kombësisë për 22 CFR 228.
- Gjobat dhe penaltitë.
- Dhënie për donacion.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

- Të gjitha shpenzimet tjera të palejueshme sipas rregulloreve federale dhe/ose të USAID, si për shembull pijet alkoolike.
- Shpenzimet indirekte si kursimet e organizatës apo benefitet tjera mbi pagë, dhe jo vetëm.

## PAKOJA E APLIKIMIT PËR GRANTE

Pakaja e aplikimit duhet të përfshijë:

- Formularin e plotësuar të aplikimit **online** (linku për formë: <https://grante.dplus.org/>);
- Buxhetin e parashikuar dhe arsyetimin e buxhetit (**vetëm në formatin EXCEL**);
- CV-të e punonjësve kyç të projektit;
- Kopjen valide të certifikatës së regjistrimit në Kosovë;
- Kopjen e statutit të organizatës;
- Numrin fiskal.

Aplikacionet duhet të jenë specifike, të plota dhe koncize.

### Afati i fundit:

Afati i fundit për të aplikuar është **11 mars, 2021, ora 17:00.**

Aplikacionet duhet të plotësohen **vetëm përmes formës online**. Në qoftë se hasni në ndonjë problem apo sfidë gjatë procesit të plotësimit të aplikacionit, ju lutem na kontaktoni përmes numrave të telefonit: +383 49 809 609 apo +383 49 618 584, ose përmes email-it: [grants@dplus.org](mailto:grants@dplus.org)

### Aplikacionet e vonuara:

Formulari i aplikimit online mbyllet në mënyrë automatike në afatin e caktuar, dhe aplikimet e paraqitura në ndonjë formë tjetër nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren në konsideratë në procesin e shqyrtimit.

### Ndarja e granteve:

Ndarja e granteve pritet të bëhet në prill, 2021.



## VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PËRFITUESVE TË GRANTEVE

### Kriteret e vlerësimit

Aplikacionet do t'i nënshtrohen dy fazave të vlerësimit teknik bazuar në kriteret e mëposhtme:

#### Faza 1:

1. Formulari i aplikimit **online** i paraqitur para skadimit të afatit, përveç nëse përcaktohet ndryshe;
2. Të gjitha dokumentet e kërkuara të paraqitura (certifikata e vlefshme e regjistrimit të Kosovës, statuti, numri fiskal);
3. Llogarija bankare e aplikuesit në njërën nga bankat në Kosovë;
4. Numri DUNS (ose deklarata se aplikuesi është në proces të marrjes së tij);
5. Formulari i duhur i Buxhetit, i paraqitur në formatin Excel, dhe shprehur në USD;
6. Narrativi i buxhetit (buget notes) në Formularin e Buxhetit, përgatitur bazuar në linjat buxhetore;
7. Buxheti në vitin e fundit fiskal nën 50,000 EUR.

#### Faza 2:

1. Iniciativa e propozuar prodhon rezultate të matshme me lidhje të qartë me katër rezultatet e CCA.
2. Kostoja totale e kërkuar është në përputhje me aktivitetet e propozuara.

Më poshtë gjeni kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e poentimit që do të aplikohet në shqyrtimin e aplikacioneve:

Kategoria për vlerësim	Pikët maksimale
Shkrimi i projektit dhe qasja	30
Impakti në grupin e synuar	30
Kapaciteti menaxherial	25
Qëndrueshmëria	15

**Shkrimi i projektit dhe qasja (30 pikë).** Kualiteti dhe fizibiliteti i aplikacionit, në kuptim të përshtatshmërisë së metodologjisë së propozuar, kreativitetit, planit të punës në përmbushjen e objektivave të projektit, si dhe mekanizmat e propozuara për monitorimin e rezultateve. Përveç kësaj, kjo kategori do t'i vlerësojë projektet në bazë të (shënim: tri elementet e paraqitura më poshtë nuk janë kërkesa, megjithatë përmes tyre aplikantët do të marrin pikë shtesë):

- Përfshirjes së partneritetit ndërsektorial (p.sh. parteriteti ndërmjet qytetarëve, qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe mediave).
- Përfshirjes së bashkëpunimit ndërmjet komunave të ndryshme.
- Shfrytëzimit të resurseve të brendshme (financiare apo në natyrë) përveç fondeve të USAID dhe donatorëve të tjerë ndërkombëtarë. Shënim: Kontributet në natyrë mund të përfshijë burime të tilla si puna vullnetare, vlerësimin e materialeve të dhuruara, pajisjeve dhe pasurive tjera, përdorimin e kostove indirekte të pariparuarueshme, dhe kohën e stafit.





**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

**Impakti në grupin e synuar (30 pikë).** Kjo kategori përfshin shkallën në të cilën projekti korrespondon me nevojat e grupit të synuar dhe masën në të cilën u sjell benefite direkte atyre. Këtu përfshihet edhe pjesëmarrja dhe përfitimi që kanë gratë, të rinjtë dhe grupet tjera të cenueshme. Po ashtu, vlerësohet niveli i nxitjes direkte apo indirekte i organizatave dhe resurseve tjera për t'i zhvilluar dhe zbatuar aktivitetet që përputhen me objektivat e projektit. Në veçanti, kjo kategori do t'i vlerësojë projektet në:

- Mënyrën e vënies në pah të ndërveprimit në komunitet. Duhet të bëhet e qartë që iniciativat që përfshihen në projekt-propozime t'i adresojnë nevojat gjithëpërfshirëse që janë ngritur nga banorët apo komuniteti përkatës përmes zgjidhjeve të bëra nga vetë banorët dhe/ose nga anëtarët e komunitetit në bashkëpunim me zyrtarët komunalë.
- Angazhimin e anëtarëve të grupeve të ndryshme etnike, grave, të rinjve si pjesëmarrës në proces të vendimmarrjes dhe/ose në implementimin e aktiviteteve.

**Kapaciteti menaxherial (25 pikë).** Dëshmi për aftësi menaxheriale për t'i ndërmarrë dhe përmbushur aktivitetet e propozuara. Kjo do të vlerësohet bazuar në përvojat e mëhershme të aplikantit në zbatimin e aktiviteteve të ngjashme, si dhe në aftësisë dhe kualifikimet e stafit të propozuar.

**Qëndrueshmëria (15 pikë).** Përmes kësaj matet shkalla në të cilën aktiviteti i financuar do të nxitë organizata dhe burime të tjera për të zhvilluar ose zbatuar më tej aktivitete që mbështesin objektivat e projektit gjatë dhe pas mbylljes së tij, si dhe sa do të rezultojë në ndërtimin dhe fuqizimin e kapacitetit të komunitetit dhe organizatave lokale. Kjo kategori gjithashtu do ta vlerësojë mënyrën e demonstrimit të angazhimit dhe vullnetit politik të qeverisjes lokale, angazhim ky me qytetarët (veçanërisht ata që nuk janë të përfaqësuar siç duhet) për çështjet që të njëjtat i identifikojnë si sfida.

Projekt-propozimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni Përzgjedhës i përbërë nga tre anëtarë: një përfaqësues nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, një përfaqësues i shoqërisë civile dhe një anëtar i stafit të D+.

Përveç kësaj, menaxheri i granteve do ta shqyrtojë koston e aplikacioneve dhe do ta verifikojë përvojën e mëhershme të aplikantëve në aktivitete të ngjashme, duke mos i vlerësuar me pikë.

**USAID rezervon të drejtën për të financuar ndonjë ose asnjë nga aplikacionet e paraqitura.**



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

## PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESAVE

*Sipas KPA janë paraparë dy lloje të granteve: Pagesa sipas pjesëve të kryera ose pas përfundimit të një pjese të projektit (FFA) dhe pagesa që i bëhet drejtpërdrejt shitësit (in-kind).*

*Pagesa **FFA** parasheh pagesa për përfituesin e grantit në përputhje me planin e pagesës dhe pas miratimit të donatorit për pjesën e kryer të projektit. Përfituesit të grantit mund t'i kryhet në fillim një pjesë e pagesës në mënyrë që të ketë likuiditet financiar dhe ta lehtësojë fillimin e implementimit të aktiviteteve të parapara. Shuma e kësaj pagese fillestare nuk mund të jetë më e lartë se shuma e shpenzimeve të përfituesit për një muaj apo 30% e buxhetit total.*

*Granti i llojit **"In-kind"** nënkupton mundësinë e CCA që të blejë mallra dhe shërbime për përfituesin e grantit duke bërë kuotimin e çmimeve dhe duke lidhur kontrata lidhur me këtë blerje. CCA mund t'i kryej pagesat për mallra dhe shërbime në emër të përfituesit. Paradhëniet nuk do të aplikohen.*



## **ANEKSI A. FUSHAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NË FORMULARIN ONLINE PËR APLIKIM**

*Ky aneks iu shërben aplikuesëve vetëm si referencë për formularin online, përderisa aplikimi duhet të bëhet në formën online siç është përshkruar më lartë.*

Formulari i aplikacionit online i përmban pyetjet e listuara si më poshtë. Disa nga pyetjet kanë limit të numrit të fjalëve dhe karakteret me hapësira të lejuara janë të vendosura tek pyetjet përkatëse.

### **Informata për aplikuesin**

- Emri i aplikuesit
- Titulli i projektit
- Buxheti total i projektit (USD)
- Shuma e kërkuar për financim nga CCA (USD)
- Vendi i implementimit të projektit
- Kohëzgjatja e projektit (në muaj)

### **Të dhëna bazike**

- Numri i regjistrimit
- Data e regjistrimit
- E regjistruar si (p.sh., fondacion, shoqatë, organizatë joqeveritare, institucion i administratës publike, etj.)
- Adresa e plotë
- Emri, titulli dhe të dhënat kontaktuese të përfaqesuesit ligjor
- Numri i telefonit
- Email adresa
- Ueb-faqja
- Buxheti total i vitit paraprak financiar
- Numri i llogarisë bankare
- Numri DUNS
- Cili është misioni i organizatës suaj
- Sa punonjës ka organizata juaj

### **Përshkrimi i projektit**

- Në cilat nga katër rezultatet e CCA kontribuon projekti juaj?
- Përmbledhja e projektit – max deri në 1000 karaktere me hapësira



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

- Partneriteti (Nëse projekti do të implementohet në partneritet me ndonjë organizatë/entitet tjetër, ofroni të dhënat si: emri, numri i regjistrimit, lloji i entitetit dhe roli i të njëjtit në projekt), nëse jo atëherë shëno N/A – max deri në 1000 karaktere me hapësira
- Partneriteti ndërsektorial (A përfshin projekti juaj partneritet ndërmjet qytetarëve, qeverisë, shoqërisë civile, sektorit privat dhe mediave?) – max deri në 1000 karaktere me hapësira
- Shfrytëzimi i burimeve tjera vendore (A do të shfrytëzojë projekti juaj ndonjë burim tjetër financiar apo burim në natyrë, përveç fondeve të kërkuara nga CCA? Nëse po, ju lutemi të elaboroni) – max deri në 1000 karaktere me hapësira

### **PJESA I: DIZAJNI DHE QASJA**

- Analiza e problemit (Shpjegoni shkurtimisht situatën që ndërlidhet drejtpërdrejt me projektin tuaj dhe ndaj së cilës do të kontribuojnë aktivitetet tuaja) – max 3000 karaktere me hapësira
- Qëllimi dhe objektivi(at) (Përshkruani në mënyrë specifike se çfarë doni të arrini përmes këtij projekti për ta adresuar problemin e përshkruar më sipër. Qëllimi dhe objektivat duhet të jenë specifike, të qarta, të matshme dhe të mundshme brenda kornizës kohore të projektit tuaj) – max 2000 karaktere me hapësira
- Aktivitetet (Përshkruani të gjitha aktivitetet që do të implementohen gjatë projektit dhe si do të kontribuojnë në arritjen e qëllimit dhe objektivave të përcaktuara) – max 5000 karaktere me hapësira
- Afati kohor i implementimit të aktiviteteve
- Përshkruani se si do të implementohen aktivitetet e propozuara, duke marrë parasysh masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19 – max 1000 karaktere me hapësira
- Rezultatet specifike të pritshme
- Përshkruani shkurtimisht rreziqet e mundshme që mund të dalin gjatë implementimit të projektit tuaj dhe se si këto rreziqe do të minimizohen – max 1000 karaktere me hapësira

### **PJESA II. IMPAKTI NË GRUPIN(ET) E SYNUAR(A)**

- Grupet e synuara të projektit përfshi mënyrën e pjesëmarrjes së tyre në aktivitete – max 1500 karaktere me hapësira
- Përfituesit (Përfshini përfituesit direkt dhe indirekt të projektit, specifikoni se si do të përfitojnë nga projekti) – max 1000 karaktere me hapësira
- Përshkruani se si planifikoni ta informoni publikun e gjerë lidhur me arritjet dhe rezultatet e projektit – max 1000 karaktere me hapësira

### **PJESA III: KAPACITETI MENAXHUES**

- Staf i propozuar për implementimin e projektit
- Përvoja paraprake në zbatimin e aktiviteteve të ngjashme – max 1000 karaktere me hapësira



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERIČKOG NARODA

#### **PJESA IV: QËNDRUSHMËRIA**

- Qëndrueshmëria e projektit – max 1000 karaktere me hapësira
- Angazhimi i qeverisjes lokale – max 1000 karaktere me hapësira

#### **ANEKSI B. FORMULARI PËR BUXHET**

Dokument i veçantë në formatin Excel (shkarkoni nga: <https://dplus.org/grantet/>).

#### **ANEKS C. UDHËZIMET PËR T’U PAJISUR ME NUMRIN DUNS**

Dokument i veçantë (i qasshëm në: <https://dplus.org/grantet/>).